



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafit 7 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 12/2019) dhe neni 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë e Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), në seancës së 46-të të mbajtur me datë 12 shkurt 2021 morri

#### VENDIM

**NDËRPRITET** procedura për lëndën numër 09-2159/1 me datë 01.04.2019 me arsyje të veprimit nga organ tjetër kompetent, pas Kërkesës për ngritje të procedurës për caktim të përgjegjësisë së gjykatësit .....

Lënda me numër 09-2159/e me darë 01.04.2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

#### SQARIM

Lënda me numër 09-2159/1 me datë 01.04.2019 është formuar në bazë të denoncimit me akuzat se Kryetari i Gjykatës themelore në ..... e ka punësuar të birin e tij më të madhë në punë në gjykatën e njëjtë themelore ku është edhe kryetarë dhe në mënyrë enorme është pasuruar me shtëpi, automobila, artaria, kafeneja, banesa, parcela ndërimi etj.

Në lidhje me akuzat e pasurimit enorm të personit ..... vetëmse është hapur lëndë në Njësinë për ndjekje të gjendjes së pronës dhe interesave.

Në drejtim të përcaktimit në gjendjes juridike dhe të plotë faktike në rastin konkret, Komisioni shtetëror u drejtua deri tek Gjykata themelore ..... dhe kërkoi të dorëzohet dokumentacioni i plotë për realizimin e procedurës për punësim të personit ..... në Gjykatën themelore .....

Nga dokumentacioni i dorëzuar është konstatuar kjo: personi ....., i biri i ish-kryetarit të Gjykatës themelore ....., tash gjyqtar në gjykatën e njëjtë paraprakisht ka qenë i punësuar nëpërmjet konkursit publik të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Sekretariati për zbatim të marrveshjes së Ohrit si bashkëpunor i ri për strategji, planifikim dhe ndjekje në Departamentin për strategji, planifikim dhe ndjekje.

Pas realizimit të procedurës për plotësim të vendeve të punës në bazë të mobilitetit pa konkurs publik, me transferim në Gjykatën themelore ....., janë transferuar pesë persona, ndër të cilët dhe personi .....

Që të realizohet procedura e përmendur, paraprakisht është marrë pëlqim për transferim të përhershëm nga Ministria për shoqëri informative dhe administratë dhënë me datë 21.05.2018 në përputhje me nenin 44 paragrafi 1 nga Ligji për punësim në sektorin publik si dhe pëlqimi i marrë nga Ministria për finansa deri tek Këshilli buxhetor Gjyqsor me datë 31.05.2018.

Personi ..... është punësuar në Gjykatën themelore ..... duke llogaritur nga 03.10.2018 në vendin e punës – kategoria "V", niveli "V4", zyrtar profesional gjyqsor të nivelit të katërt me titullin Bashkëpunor i ri gjyqsor, nëpërmjet transferit të përhershëm pa konkurs, që don të thotë në titullin që e ka pasë edhe gjatë punësimit në Sekretariatën për zbatim të marrveshjes së Ohrit.

Me datë 14.03.2018 Gjykata themelore ..... nënshkroi marrëveshje për transfer me Sekretariatit për zbatim të marrëveshjes së Ohrit pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për transfer të pesë të punësuarve.

Marrëveshja për punësim pa konkurs publik për transfer të përhershëm të djalit të tij me nr. 0402-7/27 me datë 02.04.2018 në emër të Gjykatës themelore ..... e ka nënshkruar ....., i cili në atë kohë ka qenë Kryetar i Gjykatës themelore .....

Pas përfundimit të procedurës për transfer me datë 03.10.2018 janë dhënë edhe Akt-vendimet për shpërndarje në vendet e punës të punëtorëve të transferuar, kurse akt-vendim për shpërndarje në vendin e punës të të birit të kryetarit të gjykatës e nënshkruar nën-kryetari i Gjykatës themelore.

Ish-kryetari i Gjykatës themelore ..... në përputhje me nenin 29 paragrafi 2 nga Ligji për parandalim të korrupsionit i cili ka qenë aktiv gjatë kohës së transferit dhe punësimit të të birit të tij në Gjykatën themelore ..... në afatin e paraparë me ligj prej 10 ditë, me datë 10.10.2018 e ka denoncuar punësimin e djalit të tij deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit.

Procedura pa konkurs publik me transfer të përhershëm të personit ..... është realizuar në përputhje me Ligjin për punësim në sektorin publik, mirëpo gjatë nënshkrimit të marrëveshjes për transfer nuk është respektuar nenin 12 nga Ligji për parandalim të konfliktit të interesave, i cili ka të bëjë me përjashtim, kurse i njëjti është shkruar në nenin 75 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

Nga e theksuar më parë, Komisioni shtetëror mendon se ekziston bazë për dyshim se personi zyrtar ..... – gjyqtar në Gjykatën themelore ..... gjatë kryerjes së funksionit Kryetar i Gjykatës themelore në Kërçovë i ka shfrytëzuar autorizimet e veta dhe kompetencat dhe ka vendosur në interese të personit të afërt, duke e vënë interesin në personin e afërt para interesit publike, gjegjësisht, kryerjen e punës me interes publik e ka shfrytëzuar për realizimin e qëllimeve personale.

Përshkak të arsyeve të theksuara, Komisioni shtetëror i propozoi Këshilli gjyqsor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në përputhje me kompetencat e veta, të ngritë procedurë për vërtetimin e përgjegjësisë të personit zyrtar ..... – gjyqtar në Gjykatën themelore .....

Me datë 10.12.2020 është mbajtur diskutim në hapsirat e Këshillit gjyqsor në lidhje me kërkesën për ngritje të procedurës për vërtetim të përgjegjësisë të gjyqtarit Baki Alili në Komisionin shtetëror, në të cilën është ftuar edhe gjyqtari i përmendur. Parashtruesi i kërkesës, në këtë rast anëtar i autorizuar i KSHPK për lëndën Nuri Bajrami theksoi se gjithçka që është konstatuar është publikuar dhe qëndron pas vendimit të marrë nga Komisioni shtetëror, në përputhje me procedurën e paraparë gjatë konstatimit të shkeljes të LPKKI, Komisioni shtetëror u drejtua deri tek organet kompetente në këtë rast deri tek Këshilli gjyqsor i RMV. Gjyqtari ..... në fjalën përfundimtare të tij theksoi se akuzat në kërkesën janë të pabazë dhe pa mbështetje, në situatë kur i biri i tij tashmë nuk është në marrëdhënie pune në Gjykatën themelore ..... Në diskutimin e përmendur janë shpalosur dëshmi të cilat i posedon Këshilli gjyqsor i RMV. Në fund të diskutimit është theksuar se në bazë të nenin 69 nga Ligji për Këshilli gjyqsori RMV, Këshilli në senacën diskutoi për raportin e komisionit dhe pas

mbarimit të diskutimit vendosë. Për vendimin do të informohet edhe parashtruesi i kërkesës dhe gjyqtari kundër të cilit është parashtruar kërkesa.

Me datë 30.12.2020, Këshilli gjyqsor i RMV vendosi për kërkesën për vërtetim të përgjegjësisë së personit zyrtar ..... gjyqtar në Gjykatën themelore ....., dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror, pas realizimit të procedurës, në përputhje me nenin 69 paragrafi 4 nga Ligji për Këshillin gjyqsor të RMV, në lidhje me nenin 78 nga Ligji për gjykata në senacën e mbajtur me datë 24.12.2020 morri vendim se personi ....., gjyqtar në Gjykatën themelore ..... i shqiptohet vërejtje me shkrim në përputhje me nenin 78 paragrafi 1 alinea 1 nga Ligji për gjykata, për shkelje disiplinore të kryera sipas nenin 77 paragrafi 1 pika 2 nga Ligji për gjykata.

Në bazë të tërë të shënuarës më sipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi sipas dispozitave.

Pas përfundimit të KSHPK

Përpunoi: S. M., bashkëpunor i lartë

Miratoi: m-r V. G., anëtar i KSHPK

**KOMISIONI SHTETËROR PËR  
PARANDALIM TË KORRUPTIONIT**  
Kryetarë: Biljana Ivanovska